



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Sh.II.nr.1561/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore SH.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.T.B “Ballabani Komerc” me seli në rr.“Agim Ramadani” nr.22/96, Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Florian Petani, avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbarimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.522/2023 të datës 07.07.2023, me datë 12.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore SH.A., me seli në Prishtinë, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.522/23 i datës 07.07.2023, dhe Lënda i kthehet të njëjtës gjykatë, në rivendosje dhe rigjykim

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.522/2023 të datës 07.07.2023, ka aprovuar prapësimin e debitorit N.T.B “Ballabani Komerc”, ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.195/2022 të datës 08.04.2022 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Kushtrim Metaj dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimin në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore, me propozim që të aprovohet ankesa, ashtu që aktvendimi i ankimuar të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ndërmarrja Publike Banesore SH.A., me seli në Prishtinë, me datë 05.04.2022 ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit N.T.B “Ballabani Komerc” me seli në rr.“Agim Ramadani” nr.22/96, Prishtinë, në bazë të dokumenti të besueshëm – faturës nr.2022/0857 dhe Kartelës Financiare të datës 29.03.2022, në shumën e përgjithshme prej 12,876.90 Euro.

Përmbartuesi privat Kushtrim Metaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.195/2022 të datës 08.04.2020, ka lejuar përmbartimin kundër debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbartim.

Kundër këtij urdhri përmbartimor debitori me datë 28.04.2022 ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se dokumenti në bazë të së cilit është marr urdhri përmbartues nuk përbënë titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, për shkak se kartela financiare e paraqitur nga kreditori nuk mund të cilësohet si ekstrakt i verifikuar nga librat afarist. Më tutje ka deklaruar se fatura e lartcekur ka të bëjë me faturimin e qirasë për një lokacion tjetër, si dhe kjo kërkesë e qirasë është parashkruar konform dispozitave të nenit 360 të Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD). Andaj, ka propozuar që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbartimor.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 06.05.2022, duke e kundërshtuar prapësimin e debitorit, me arsyetimin se kreditori ka vepruar komform rregullave ligjore me rastin e paraqitjes së urdhrin përmbartimor duke i respektuar të gjitha procedurat dhe duke i bashkëngjitur Faturën Kthyes Nr. 2022/0857 të datës 01.03.2022 dhe Kartelën Financiare të datës 29.03.2022 si dokumente të besueshme të cilat e kanë fuqinë e titullit përmbartues. Ka shtuar se debitori me pagesën në shumën prej 400.00 € e cila evidentohet nga dëftesë pagesa e datës 16.03.2022, ka ndërprerë parashkrimin konform dispozitave të nenit 368 të LMD-së. Andaj ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar, ndërsa urdhri për caktimin e përmbartimit P.nr.195/22 i datës 08.04.2022 të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.522/2023 të datës 07.07.2023, me të cilin ka aprovuar prapësimin e debitorit N.T.B “Ballabani Komerc”, ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.195/2022 të datës 08.04.2022 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj dhe ka përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas vlerësimit të prapësimit, përgjigjes në prapësim dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi, për shkak se Fatura nr. 2022/0857 e datës 10.03.2022 dhe Kartela Financiare e datës 29.03.2022 në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Tutje ka arsyetuar se dokumenti i besueshëm - Fatura nr. 2022/0857 e datës 10.03.2022, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nga kjo faturë nuk mund të vërtetohet se për cilën periudhë kohore është kërkuar borxhi, për cilat shërbime është lëshuar e njëjta, sepse në faturë është përshkruar vlera e faturës pas tatimit mbi qiranë 9 %, për një muaj, në shumën prej 565.45 € dhe 395.45 €, ndërsa borxhi total i kërkuar sipas faturës është në shumën prej 12,876.90 €, andaj shërbimi i përshkruar në këtë faturë nuk përputhet me borxhin total i cili kërkohet sipas të njëjtës. Andaj duke qenë se fatura nuk e përmban objektin e detyrimit siç përcaktohet sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, e njëjta nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. Po ashtu gjykata vlerëson se dokumenti i bashkëngjitur këtij propozimi përkatësisht Kartela Financiare e datës 29.03.2022, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se një dokument i tillë, bazuar në dispozitën e nenit 29 paragrafi 1 të LPP-së, nuk është i përcaktuar si dokument i besueshëm, pasi që bazuar në këtë dispozitë është përcaktuar se në kuadër të dokumenteve të besueshme janë ekstraktet e verifikuara nga librat afariste vetëm sa i përket pagesave të shërbimeve komunale për furnizim me ujë, energji elektrike dhe bartje të mbeturinave. Andaj duke marr parasysh faktin se në rastin konkret propozimi për përmbartim është lejuar sipas një dokumenti - kartelës financiare në kuadër të Ndërmarrjes Publike Banesore, gjykata vlerëson se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk konsiderohet dokument i besueshëm dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata Komerciale -Dhoma e shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të dhomës së shkallës së parë, nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së.

Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk mund ta pranojë vlerësimin e dhomës së shkallës së parë pasi gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ashtu që edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Dhoma e shkallës së dytë ka vendosur që ta anuloj aktvendimin e dhomës së shkallës së parë, dhe lëndën ta kthejë në rivendosje dhe rigjykim.

Në këtë rast dhoma e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejt ligjshmërinë e dokumenteve përmbartimore: si kartela financiare datës 29.03.2022 dhe fatura nr.2022/0857 dt.10.03.2022 të

kreditorit, në bazë të cilave është lejuar propozimi për përmbarrim, duke mos i konsideruar si dokumente të besueshme, referuar dispozitës së nenit 29 paragrafi 1 dhe 37 të LPP-së, dhe në aktvendimin e atakuar nuk janë dhënë vlerësime në përputhje me dispozitat ligjore dhe gjendjen faktike mbi atë çka përmbajnë shkresat në lëndë.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se dokumenti - Kartela Financiare e datës 29.03.2022, si dokument publik, në bazë të së cilës është iniciuar procedura përmbarrimore, është dokument përmbarrues dhe i përshtatshëm për përmbarrim, i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarrim, si dhe i plotëson kushtet ligjore nga neni 29 paragrafi 1 pika 1.2 dhe 1.3, 1.4 të LPP-së, që parashohin:

*Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është:*  
*ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike;*

Dhoma e shkallës së dytë nuk e ka pranuar si të drejtë përfundimin e dhomës së shkallës së parë se kartela financiare e kreditorit në bazë të cilit është lejuar urdhri për përmbarrim, nuk është dokument i besueshëm nga neni 29 paragrafi 1 të LPP-së. Kjo gjykatë vlerëson se dispozitat ligjore të lartcekura kartelën financiare në këtë rast të kreditorit, e përfshijnë si dokument të besueshëm në bazë të cilit realizohet përmbarrimi, pasi që edhe kartela financiare për periudhën 2019-2022 e kreditorit, duhet trajtuar si dokument publik, që është ekstrakt, evidencë e kreditorit për klientët, që paraqet gjendjen e debi-kredisë së klientit, në pagimin e borxhit në këtë rast për periudhën e lartcekur. Kjo gjykatë gjithashtu nuk e pranon si të drejtë konstatimin e dhomës së shkallës së parë, se fatura nr.2022/0857 e datës 10.03.2022 në bazë të cilës është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm. Fatura në fjalë përmban periudhën kohore për të cilën është kërkuar borxhi (mars 2022).

Nga shkresat e lëndës, respektivisht deklaratimet e palëve ndërgjyqëse në prapësim dhe përgjigje në prapësim, janë relevante faktet vendimtare të cilat nuk i ka trajtuar dhoma e shkallës së parë, në drejtim të parashkrimit të kërkesave të qirasë, ku debitori në prapësimin e datës 28.04.2022, thekson se përmbarrimi i kërkesave mbi qiranë për periudhën janar 2019-mars 2019 në shumën 1,696.35€ nuk mund të kërkohej për shkak të parashkrimit nga neni 356 të LMD-së, ndërsa kreditori në përgjigjen në prapësim deklaroi se debitori me pagesën prej 400.00€ dt.16.03.2022, ka ndërprerë përshkrimin nga neni 368 të LMD-së.

Në ri procedurë, Dhoma e shkallës së parë, duhet të marrë parasysh të gjeturat e lartcekura, të evitohet parregullsitë e gjetura, të vendoset në lidhje me kërkesën e përshkrimit të borxhit, dhe pastaj të marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm konform dispozitave ligjore në fuqi.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.Dh.Sh.II.nr.1561/2023, me datë 12.04.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha